



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

KONFERENCA E DYTË NDËRKOMBËTARE

Institucionet arsimore të sigurisë publike, faktor kyç në
forcimin e rendit dhe sigurisë

7 - 8 nëntor, 2018

Prishtinë - Vushtri, Kosovë

THIRRJE PËR PJESËMARRJE

KONFERENCA E II-të NDËRKOMBËTARE
Nëntor 2018, Prishtinë - Vushtrri, Kosovë

INSTITUCIONET ARSIMORE TË SIGURISË PUBLIKE, FAKTOR KYÇ NË FORCIMIN E RENDIT DHE SIGURISË

Thirrje për aplikim

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, më 7 dhe 8 nëntor 2018, do të organizojë konferencën shkencore ndërkombëtare me titull "Institucionet arsimore të sigurisë publike, faktor kyç në forcimin e rendit dhe sigurisë".

Të interesuarit për të marrë pjesë në konferencë, akademikë, studentë, hulumtues dhe profesionistë tjerëtohen që të prezantojnë punime të tyre në fushën e sigurisë publike. Konferenca do të mbahet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, me mundësinë e përkthimit simultan në gjuhët e lartpërmendura.

Arsyetimi i temës bosht të konferencës

Arsimimi i mirë në përgjithësi është parakushti i mirëqenies së një shoqërie, gjegjësisht kushti themelor i jetës së mirë të njerzëve gjithandej globit.

Arsimimi i mirë në fushën e sigurisë është po ashtu parakusht për ofrimin e shërbimeve të mira të sigurisë për qytetarët e një vendi dhe faktor i rëndësishëm për rritjen dhe forcimin e sigurisë në fqinjësi dhe më gjërë.

Marrë si tërësi, mirëqenia e një shoqërie, përfshirë këtu sigurinë publike, qëndron në raport të drejtë me investimin që bëjnë shoqëritë në arsimimin e qytetarëve të saj: investiminë arsimim dhe trajnim të zbatuesve të ligjit me qëllim të forcimit të sigurisë publike të një vendi paraqet specifikën dalluese të kësaj lëmie të arsimimit dhe trajnimit në krahasim me tjerat. Në ndërkohë që në sferat tjera të arsimimit dhe trajnimit rezultatet presin një kohë për t'u dukur të prekshme, në sferën që është objekt i kësaj konference rezultatet janë evidente dhe të prekshme në një kohë më të shkurtër.

Studimet dhe hulumtimet e viteve të fundit kanë dëshmuar se vendet me mirëqenie të nivelit të lartë, përfshirë sigurinë e duhur publike, vazhdojnë të i risin investimet në arsimimin e qytetarëve të tyre.

Sfidat vazhdimisht të ndryshueshme me të cilat përballet sot shoqëria në përgjithsi, duke përfshirë dhe ato në fushën e sigurisë publike, obligojnë shoqëritë e organizuara të rrisin investimet në arsimim, duke përfshirë investimin në arsimimin dhe trajnimin në fushën e sigurisë publike me qëllim të përballjes me këto sfida kërcënuese për njerzimin.

Investimi në institucionet arsimore – trajnuese të sigurisë është faktor kyç në forcimin e rendit dhe sigurisë publike. Kjo vlenë edhe për Kosovën. Kjo ka vlejtur për të gjitha vendet ish-komuniste të Evropës. Në rastin e Kosovës, marrë parasysh gjendjen që ka ekzistuar në dekadat e fundit para çlirimit, kjo temë bëhet edhe më akute dhe nevoja për ndriçimin e aspekteve të caktuara të saj, edhe më e rëndësishme. Ka kaluar koha që Kosova dhe siguria publike e saj të trajtohen si çështje emergjente dhe e trajnimeve ad hoc: çështja e sigurisë publike dhe rolit të arsimit duhet të trajtohet në dritën e institucioneve të forcuara të sigurisë, të cilat kanë nevojë për azhurnime dhe përditësime specifike, të cilat i kanë kryer vendet tjera në rajon dhe më gjërë.

Synimi i konferencës

Konferenca synon të bashkojë studiuesit e fushave të sigurisë publike nga regjioni i Ballkanit dhe vendet evropiane me qëllim të prezantimit të modeleve të institucioneve arsimore dhe trajnuese të vendeve të tyre, përvojat, sfidat e kaluara dhe aktuale si dhe të gjeturat nga hulumtimet nga fusha arsimore – trajnuese të zbatuesve të ligjit. Kosova, më shumë se çdo vend tjetër evropain, ka nevojë për të vjelur nga përvojat dhe rezultatet e arritura gjetiu dhe të mësojë nga metodologjia e përdorur gjetiu.

Objekti i konferencës

Objekti kryesor i konferencës është trajtimi i rolit dhe ndikimit të arsimit në funksion të misionit të institucioneve të zbatimit të ligjit, marr parasysh sfidat vazhdimisht të ndryshme të cilat po ndodhin gjithandej globit.

Në këtë kontekst, hulumtimet të cilat do të shpalosen në konferencë, duke përfshirë rekomandimet të cilat mund të dalin nga konferenca, do të shërbejnë për përmirësimin e programeve studimore në fushën e sigurisë si dhe krijimin e programeve të reja të funksion të ngritjes të kompetencës të atyre që ofrojnë shërbime në fushën e sigurisë publike. Ngritja e njohurive dhe shkathtësive të zbatuesve të ligjit përbën një nevojë të kohës dhe një domosdoshmëri nga e cila nuk duhet të ikim: shoqëritë që hapin debat për dobësitë e veta dhe shikojnë ballëhapur në të kaluarën dhe në përvojat dhe rezultatet e tjetërëve janë më të suksesshme.

Datat e rëndësishme dhe modeli i pjesëmarrjes në konferencë

Bazuar në thirrjen për aplikim në konferencë, ftohen akademikë, studentë, hulumtues dhe profesionistë tjerë të pavarur ose të punësuar në Agjencitë e Sigurisë Publike, institucionet e shtetit, institucionet e arsimit ose hulumtimit nga Kosova, vendet e regjionit dhe vendet partnere ndërkombëtare, të marrin pjesë me punimet, gjegjësisht hulumtimet e tyre në konferencë. Punimet dhe prezantimet nuk duhet të kenë qenë të botuara apo prezantuara më parë gjetiu.

Dorëzimi i abstrakteve deri më 30 gusht 2018

Njoftimi i pranimit të abstrakteve 5 shtator 2018

Dorëzimi i punimeve deri më 20 tetor 2018

Njoftimi i pranimit të punimeve 1 nëntor 2018

Data e konferencës 7 - 8 nëntor 2018

Propozimi ose abstrakti duhet të përmbajë 250 - 300 fjalë, me 4 - 5 fjalë kyçe, duhet të dërgohet në e-mail ose CD në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Gjuhët zyrtare janë shqip, serbisht dhe anglisht. Abstrakti i punimeve të paraqitura në gjuhën shqipe dhe serbe duhet të dërgohet edhe në gjuhën angleze.
- Emri i plotë i autorit/ autorëve, përkatësia institucionale dhe e-mail adresa.
- Teksti të shkruhet dhe shtypet me hapësirën 1.15 ndërmjet rreshtave në fondin "Times New Roman" dhe madhësia e shkronjave duhet të jetë 12.

Pas dorëzimit të abstrakteve dhe vlerësimit, bazuar në orarin më sipër, autorët do të njoftohen për pjesëmarrjen e tyre në konferencë.

Punimet do të dorëzohen po ashtu bazuar në orarin më sipër. Bordi shkencor do të përzgjedhë punimet më të mira të cilat do të prezantohen gjatë punimeve të konferencës. Nëse punimet pranohen nga Bordi, autorët do të njoftohen për pjesëmarrje në konferencë.

Për çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem kontaktojeni personin kontaktues të konferencës, z. Avni Istrefi, e-mail: konferencaaksp@rks.gov.net dhe tel. +383 (0)44 165952.

Punimet e konferencës do të botohen në një vëllim/libër të pajisur me ISBN.

Informacione mund të gjenden në faqen zyrtare të Akademisë së Kosovës për Sigurisë (<http://www.aksp-ks.net>), në shtyllën "Fakulteti i Sigurisë Publike/ Hulumtimet/ Konferenca" <http://www.aksp-ks.net/fsp/>

Do t'iu ishim mirënjohës nëse ju e ndani këtë thirrje për pjesëmarrje të konferencës edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj. Ju falënderojmë për interesimin tuaj.